



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me dt. 23.04.2018	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-130/A

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel: +381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Këshilli Drejtues

Nr. ref. 130/A

Datë: 23/04/2018

Në bazë të nenit 19 pika 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, nenit 27 pika 2 e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" nr. 04-V-621, Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 20.04.2018, mori vendim për të shpallur:

K O N K U R S

për

Rektor të Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren

1. Të ketë përvojën e dëshmuar në mësimdhënie akademike, kërkime shkencore dhe gradën, më së paku, të profesorit të asocuar.
2. Të ketë përvojën e dëshmuar, menaxhuese universitare.
3. Njohja e gjuhëve të huaja, është përparësi.

Kandidatët së bashku më kërkesë, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- Biografinë e shkurtër (CV-në);
- Certifikatën e lindjes;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshminë që nuk është nën hetime penale;
- Vendimin mbi thirrjen akademike (të noterizuar);
- Diplomat universitare për tri nivelet e studimit (të noterizuar);
- Dëshminë mbi përvojën akademike dhe menaxheriale në arsimin e lartë;
- Vizionin mbi menaxhimin katërvjeçar të universitetit.

Procedura e përzgjedhjes:

- Për pozitën e rektorit, konkurrimi është i hapur për stafin e brendshëm dhe të jashtëm;
- Zgjedhja e Rektorit bëhet në bazë të nenit 19 paragrafi 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës si dhe nenit 26 dhe 27 të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti".

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë kandidatët pa asnjë lloj diskriminimi, të cilët i plotësojnë kriteret ligjore të parapara për këtë pozitë.

Dokumentet e kompletuara në kopje fizike dorëzohen çdo ditë pune, prej orës 9:00 – 15:30 në zyrën e personelit nr. 526, administrata qendrore; adresa: “Ruga e Shkronjave”, p.n. 20 000, Prizren - Republika e Kosovës.

Aplikacioni i drejtohet Komisionit Profesional, të formuar nga Senati i Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Të gjitha dokumentet përveç në kopje fizike, dërgohen edhe në formë elektronike (të skanuara) në adresën: apliko.upz@uni-prizren.com.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Universitetit, përkatësisht nga data 23.04.2018 deri më 07.05.2018 në orën 15:30.